Nga e majta: Marigonë Shkoza (Praktikante) dhe Nora Dobruna (Zyrtare Ligjore).

Intervistë me: **NORA DOBRUNA**
nga: **MARIGONË SHKOZA**

"Puna me palë ka veshtirësi të tjera. Kërkon angazhim, profesionalizëm dhe stabilitet emocional për të tejkaluar sifdat e të punuarit me palë"

Një copë gjelbërim e cila ka shpëtuar nga urbanizmi i viteve të fundit, mund te shihet nga zyra e vogël e vendosur në zemër të qytetit të Gjakovës. Në katin e dytë të së njejtës ndërtesë, e cila paraqet shpirtin e kulturës së këtij qyteti, Pallati i Kulturës në Gjakovë, çdo ditë sheh njerëz të cilët hyjnë të kërkojnë zgjidhjen për problemet e tyre. Njerëz me halle të ndyshme, që pos të tjerash përballen edhe me probleme ekonomike dhe ligjore. Në këtë zyrë shpesh sheh njerëzit që thjesht kanë nevojë t'i dëgjojë dikush. Çdo problem nuk është i njejtë dhe çdo rast kërkon zgjidhje unike.

Nora Dobruna - Zyrtare Ligjore

Në atë zyrën e vogël në Gjakovë për të cilën unë kam ndëgjuar së pari të flitet nga shfrytëzues të Gjykatës, punon një grua e quajtur Nora Dobruna. Në komunitet e saj është bërë si një heroinë dhe të cilën të gjithë e shohin si një person që i dëgjon dhe ka zgjidhje për secilin prej tyre. Kur futesh së pari në Zyrën për Ndihmë Juridike, përballesh me buzëqeshjen e një gruaje modeste, që të përshëndet ngrohtësisht e të afron me një pritje të jashtëzakonshme, e kupton që me të vërtetë je në vendin e duhur.

Nora ka një zemër të madhe dhe gjithmonë e ka dashur punën e saj. Prandaj, edhe në rrugë mund të vëresh njerëzit që shpesh ndalen për ta përshëndetur. Unë si një praktikante kam mësuar nga ajo që jo të gjithë do të sillen mirë me ty, por ti gjithmonë duhet të tregosh anën tënde më të mirë. Gjithashtu më ka mësuar se të qenit juriste do të thotë jo vetëm të përfitosh nga profesioni, por edhe të japësh.

Prandaj, kjo intervistë e bërë me Nora Dobrunën, shpresoj t'ju japë disa mësime të vlefshme, ashtu sic më ka dhënë mua.

1. Ke shumë vite që punon në zyren rajonale të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, a mund të na thuash se si ke filluar punën në këtë zyrë?

Punën në Agjenci e kam filluar në vitin 2015. Puna në zyrën e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nuk ka qenë e lehtë përkundër përvojës time. Ambientimi, kolegialiteti dhe kryerja e detyrave të punës kanë qenë fokusi im i parë. Kjo ka paraqitur vështirësi derisa kam prezentuar vlerat e mia personale duke i bashkëngjitur edhe përvojën profesionale. Puna me palë ka veshtirësi të tjera. Kërkon angazhim, profesionalizëm dhe stabilitet emocional për të tejkaluar sifdat e të punuarit me palë. Kategoria e qytetarëve të cilët kërkojnë ndihmë nga ne janë të atakuar me padrejtësi. Prandaj, dua të sigurohem që kam respektin e tyre dhe që ata janë të kënaqur me shërbimet e mia. E konsideroj si investim ne anën time humane dhe profesionale. Kështu unë marr energjinë e duhur për të përfunduar detyrat ditore.

2. A mund të kujtoni dhe të ndani me ne disa nga momentet kur ju jeni ndier krenare për punën të cilën e bëni në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas?

Krenare? Po ka raste kur ndihem e tillë. Më kujtohet një rast kur pala e drejtuar tek ne, nga një palë tjetër, nuk ka besuar se mund t'i ndihmojmë. Arrita të fitoj besimin e tij përmes komunikimit dhe këmbëngulsisë. Jam ndier krenare kur pala ka ardhur të më falenderojë personalisht, pasi që kishte fituar rastin. Ai kish humbur besimin që dikush do të mund t'i ndihmonte me problemin e tij ligjorë, e aq me pak për të fituar rastin. Një rast tjetër kur jam ndjerë krenare me punën time, ishte kur një palë erdhi për të më vizituar pas disa vitesh. Ajo më tha që falë shërbimeve te mija të ndihmës juridike, ajo mund të ishte sot bashkë me fëmijët e saj. Kjo vjen bashkë me shumë emocine brenda saj, që nuk shënohen askund, por ato mund të ndjehen.

Nora dhe Marigona në zyrën rajonale në Gjakovë

3. Përse e keni zgjedhur profesionin e juristes, dhe nëse do të mund të ktheheshit në kohë a do të zgjidhnit një profesion tjetër?

Në kohën kur është dashur të bëj zgjedhjen e profesionit nuk ka pasur shumë mundësi të zgjedhjes së profesioneve. Bazuar në rrethanat e asaj kohe, besoj që ka qenë e pashmangshme për mua një zgjedhje e tillë. Periudha e viteve të 90'ta, ka në qenë kohë kur kemi bërë përpjekje të gëzojmë të drejta bazike, duke filluar nga e drejta për jetë, liri dhe barazi për qytetarët. Këto rrethana shoqërore dhe politike kanë pasur ndikim tek unë që të bëhem juriste. Kur shoh pas, e kuptoj që do të zgjidhja profesionin e njëjtë përsëri. Tani e shoh se vendimi për përzgjedhjen e një profesioni të tillë ka qenë vendimi i drejtë.

4. Ju keni punuar një kohë në Strehimore. Akoma vazhdoni ndihmoni gratë që vijnë nga Strehimore duke ju ofruar shërbime ligjore. Si ndiheni kur ndihmoni në këto raste?

Për më shumë se 15 vite kam qenë e angazhuar edhe në strehimoren në Gjakovë për gratë dhe vajzat viktima të dhunës në familje. Është përvojë e jashtëzakonshme gjë që më ka ndihmuar në trajtimin e rasteve të dhunës në zyrën tonë. Dhuna në familje është problem shumë dimensional. Kështu që është e nevojshme një qasje gjithëpërfshirëse dhe e ndjeshme ndaj këtyre rasteve. Meqenëse zyra jonë është një prej hallkave kryesore dhe shumë të nevojshme në ofrimin e ndihmës, për këto raste konsideroj që gjithmonë trajtohen nga ana jonë me seriozitetin e duhur, duke shpresuar që ndihma e dhënë nga ne e bën më të lehtë rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.

5. Sa keni qenë e gatshme dhe e përgaditur për të kaluar këtë sfidën e COVID-19 e cila është bërë temë në të gjithë botën këto muajt e fundit? Sa ka qenë sfiduese për ju të punoni gjatë kësaj kohe?

E gatshme dhe e përgaditur ndoshta plotësisht jo, sepse ishte një situatë e panjohur për mua. Këto janë rrethana të reja në gjithë botën. Unë munduar të përshtatem që të ballafaqohemi suksesshëm me situatën gjatë, angazhimit me punë. Në fillim ka qenë krejt e pazakontë që të mbajmë distancë me njerëzit. Filluam të punojmë nga shtëpitë, takimet me menaxhmentin dhe kolegët po mbahen online, etj. Përmes teknologjisë mundëm të marrim pjesë në trajnime online dhe disi filluam të funksionojmë si komunitet, dhe si shoqëri në përgjithësi. Për mendimin tim kjo sfidë na dha mundësi të reja që i konsideroj avancim personal dhe avancim të të gjithë shoqërisë. Tani po i mbajmë trajnimet online dhe ofrojmë shërbime online. po funksionojnë trajnimet online.

6. Cilat janë objektivat e juaja si përgjegjëse e zyrës rajonale te Agjencise për Ndihmë Juridike Falas në Gjakovë pas pandemisë?

Pas pandemisë rifillimi i punës aty ku kemi mbetur dhe funksionalizimi i institucionit është primar. Është shumë e rëndësishme që asnjëherë të mos ndalem përderisa edhe kam një përgjegjësi të tillë. Konsideroj se duhet të mendohen qasje të reja në promovimin e punës dhe shfryëtzimin e mundësive për këtë ndihmë nga ana e qytetarëve. Ende ka nevojë për avancim profesional që kërkojnë trajnime të ndryshme, jo vetëm në fushën e drejtësisë, por edhe në fushën e psikologjisë.

Në lidhje me këtë intervistë: *Kjo intervistë u zhvillua nga praktikantë të aktivitetit Drejtësia Vlen si pjesë e projektit "te dëgjimit": Intervistë me profesionistë ligjor. Aktiviteti Drejtësia Vlen është një projekt tre vjeçar për të përmirësuar qasjen në drejtësi për të gjithë, përfshirë grupet e disfavorizuara dhe të margjinalizuara, duke forcuar institucionet, akterët dhe proceset për ofrimin e shërbimeve dhe informacionit ligjor.*